



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Datë, 27.9.2024

Duke u bazuar në nenin 25, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore – Shkencore, nenin 2 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr.01/24, nenin 32 dhe 37 të Statutit të Institutit Pedagogjik Nr.01/B, Nr.1740, Raportin e Komisionit Vlerësues Nr.56/24, i datës 23.09.2024, Propozimin e Këshillit Shkencor i datës 26.9.2024, Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik, në mbledhjen e mbajtur më 26.9.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Dr. Osman Buleshkaj zgjedhet drejtor i Institutit Pedagogjik.
2. Mandati i drejtorit zgjatë katër (4) vite nga dita e zgjedhjes.
3. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit janë të përcaktuara me Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-shkencore, Statutin e Institutit Pedagogjik si dhe me aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në neni 25, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore, neni 38, paragrafi 4 (14) të Statutit të Institutit Pedagogjik Nr. 01/B, Nr. 1740, Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik, Vendimi datës 26.8.2024, në bazë të aprovimit nga Ministria e Arsimit (12.8.2024), shpalli Konkurs publik për pozitën e drejtorit të Institutit Pedagogjik. Konkursi është publikuar në gazetën Epoka e Re dhe në ueb faqe (29.8.2024). Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik, bazuar në neni 25 paragrafi 2 i Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore –Shkencore, neni 37 paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2. 4, i Statutit të Institutit

Pedagogjik, ka formuar Komisionin profesional-shkencor për zbatimin e procedurave për zgjedhjen e drejtorit. Komisioni profesional –shkencor i ka zhvilluar të gjitha procedurat dhe ka paraqitur Raportin e vlerësimit për secilin kandidat (23.9.2024, me nr. Protokollin 56/24, datë, 25.09.2024) dhe në bazë të paragrafit 2.10 të nenit 37, Këshilli Shkencor (me datë 26.9.2024) ka miratuar Raportin e Komisionit dhe i ka propozuar Këshillit Drejtues të Institutit Pedagogjik kandidatin për drejtor të Institutit. Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik, në mbledhjen e mbajtur më datë: 26.9.2024, me vota unanime (5) **Për**, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kandidatit të zgjedhur;
- Kandidatëve për drejtor;
- MASHTI-t;
- Departamenti për shërbime të përgjithshme.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr. Ismet Potera

